



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 59

Prishtinë, më 16.11.2016 në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Agim Çeku, Kimete Bytyqi, Ali Berisha, Fisnik Ismaili, Cerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Munguan: Mufera Shinik, Jasmina Zhivković, Milka Vuletiq, Sasha Milosavleviq dhe Slavko Simiq.

Pjesëmarrës të tjerë : përfaqësues nga OSBE-ja, Sanije Berisha; përfaqësuese nga KDI-ja, Agnesa Haxhiu; konsultant i Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtpria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Agim Çeku**, nënkryetar i Komisionit..

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e mbajtura të Komisionit me datë: 4.10.2016 dhe 1.11.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-044, për Zonën e rrezikuar mjedisor të Obiliqit dhe rreth tij me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-091, për mbrojtjen nga zhurma me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L- 090 për Sponzorimet dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L -095 për Akademinë e Drejtësisë me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Madate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Agim Çeku- nënkryetar i parë, konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e mbajtura të Komisionit me datë: 4.10.2016 dhe 1.11.2016;

Nënkryetari, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 4.10.2016 dhe 1.11.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisor të Obiliqit dhe rreth tij me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Nënkryetari, diskutoi se në kohën e fundit Komisioni po has në pengesa gjatë formimit të kворumit për arsye të mos pjesëmarrjes së deputetëve nga LS. E njoftoi komisionin se në mungesë të deputetit Fisnik Ismaili, si kryesues i komisionit ka marr konfirmimin nga ai se i mbështet shqyrtimin e projektligjeve sipas rendit të ditës dhe se pajtohet me votimin e të njejtave.

Konsideron se para vetës e kemi raportim e Projektligjit për Zonën e rrezikuar mjedisor të Obiliqit me 12 amendamente të mbështetura nga komisioni Funksional. Shfrytëzoi rastin të përgëzoj të gjithë ata të cilët kan kontribuar në sponsorimin e të njejtit.

Sa i përket Projektligjit për Zonën e rrezikuar mjedisor të Obiliqit dhe rreth tij ka një rëndësi të veçantë dhe me miratimin e tij do të krijohen kushtet për përmirësimin e jetës së qytetarëve që jetojnë në këtë komunë me rrethinën e vet.

Njëherit e njoftoi komisionin se për këtë pikë të rendit të ditës kan paraqit interesim të jenë prezent Daut Haradinaj- deputetë, Gjafer Gashi- kryetari i komunës së Obiliqit.

Fillimisht, për diskutim fjalën iu dha të pranishmëve.

Daut Haradinaj, falenderoi anëtarët e komisionit për mirëkuptim dhe theksoi se ky Projektligjit për është shqyrtuar në legjisllacionin paraprake dhe i njejt është procedurë edhe në këtë legjisllaturë. Pikërisht, qëllimi kryesor i këtij Ligji është të favorizohet jeta e qytetarëve që jetojnë dhe veprojnë në komunën e Obiliqit dhe se i njejt nuk dëmton interesat e komuniteteve. Për këtë arsye, ai kërkoi të marr përkrahjen e plot nga ky komision dhe të miratohet raporti me amendamentet e komisionit funksional në Projektligjin për Zonën e rrezikuar mjedisor të Obiliqit dhe rreth tij.

Gjafer Gashi, kryetari i komunës së Obiliqit, shfrytëzoi rastin të falenderojë të gjithë ahterët të cilët kan kontribu në hartimin e Projektligjit për Zonën e rrezikuar mjedisor të Obiliqit dhe rreth tij.

Në këtë komunë, shfrytëzohen 72% të territorit për prodhimin e energjisë elektrike me ç'rast furnizojn me drita gjithë territorin e Kosovës. Ky ligj ka një rëndësi të veçant dhe në rastin e miratimit të tij ju mundësohet përmirësimi i jetesës së qytetarëve të cilët jetojnë në këtë komunë.

Nënkryetari, falenderoj të pranishmit për dhënjen e sqarimeve të duhura.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesi konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 03/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisor të Obiliqit dhe rreth tij dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-091 për mbrojtjen nga zhurma me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Nënkryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjit nr. 03/L-091 për mbrojtjen nga zhurma me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 03/L-091 për mbrojtjen nga zhurma dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L- 090 për Sponzorimet dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;

Nënkryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L- 090 për Sponzorimet dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L- 090 për Sponzorimet dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L -095 për Akademinë e Drejtësisë me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Madate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Nënkryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L -095 për Akademinë e Drejtësisë me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L -095 për Akademinë e Drejtësisë dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

7. Të mdryshme

Nënkryetari, konsideron se nuk ka pyetje shtesë dhe konstatoi takimin e mbedhjes të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetar i Komisionit

Agim Çeku